



ICKDM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

93
KKDM/Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 16/07/2025

VENDIM

Nr. 21, datë 16/07/2025

PËR
BUXHETIN E SHPENZIMEVE PER AKTIVITETET DHE PAGAT
E KKDM DHE KTPD GJATE VITIT 2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM-së Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 16.07.2025 mori në shqyrtim Buxhetin e shpenzimeve të nevojshme për Aktivitetet dhe Pagat e KKDM dhe KTPD sipas kërkesave të legjislacionit të mesipërm ne fuqi.

Gjatë mbledhjes u shqyrtuan dhe u diskutuan aktivitetet kryesore të KKDM-së dhe strukturave mbështetëse të tij për vitin 2026, si dhe detyrimet e përcaktuara në legjislacion për përfaqësimin e shtetit Shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD) dhe në aktivitetet e organizuara nga ky Komision.

Gjithashtu, Komiteti diskutoi edhe për aktivitetet kryesore të parashikuara nga KKDM për vitin 2026 në lidhje me prëgatitjen e standardave teknike në fushën e monitorimit të digave me material vendi dhe masave antisizmike në këtë sektor, organizimin e trainimeve për shfrytëzuesit e digave në lidhje me operimin dhe monitorimin e digave, promovimin e sektorit të sigurisë së digave, kontrollin 10 vjeçar të sigurisë së digave të mëdha sipas ligjit dhe prioriteteve të përcaktuara nga Komiteti, mbështetjen e përparimit teknik në fushën e sigurisë së digave, bashkëpunimit me organizata analoge Europiane, etj. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të miratoj Buxhetin për vitin 2026 të propozuar nga ekipi i punës, lidhur me shpenzimet e domosdoshme për aktivitetet dhe pagat e KKDM dhe KTPD sipas tabelës bashkëlidhur këtij Vendimi.
- 2- Ti propozoj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) si dhe Keshillit të Ministrave miratimin e këtij buxheti si pjesë e buxhetit të MIE, i cili është i nevojshëm për plotësimin e detyrave të përcaktuara në ligj si dhe realizimin e aktiviteteve të parashikuara për vitin 2026, të përmendura më sipër.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në kete vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI